KONTABILITETI

Mësimdhënës: Ylber PREKAZI

10. Pasuria afatshkurtër dhe afatgjatë

- Kuptimi dhe karakteristikat e përgjithshme të pasurisë afatshkurtër;
- Klasifikimi i pasurisë afatshkurtër;
- Kuptimi dhe klasifikimi i pasurisë afatgjatë;
- Regjistrimi kontabël i pasurisë afatgjatë;
- Zhvlerësimi (depreciation), amortizimi (amortization) dhe harxhimi (depletation) i pasurisë afatgjatë;

Kuptimi dhe karakteristikat e përgjithshme të pasurisë afatshkurtër

- **Pasuria afatshkurtër përfshin:**
  - **Pasurinë që njësia ekonomike e zotëron ligjërisht dhe merrë përfitime dhe rreziqet në lidhje me to;**
  - **Njësia ekonomike pret prej tyre përfitime ekonomike për një periudhë më të shkurtër se 12 muaj nga data e ndërtimit të pasqyrave financiare.**

Klasifikimi i pasurisë (aktive) afatshkurtër

- Pasuria (aktive) afatshkurtër likuide
- Pasuria (aktive) afatshkurtër financiare
- Pasuria (aktive) afatshkurtër jofinanciare

Llojet e të arkëtueshmeve

- Llogaritë e arkëtueshme
- Dëftesat e arkëtueshme
- Të arkëtueshmet tjera

- ***Llogaritë e arkëtueshme*** janë të drejtat për shumat e borxhit ndaj firmave blerëse dhe individëve, të krijuara nga shitjet e mallrave dhe shërbimeve me afat pagese (kredit).
- ***Dëfetsat e arkëtueshme*** janë instrumente monetare kreditore, të cilat zotëruesit të saj I japin të drejtë për të arkëtuar shumën e kryegjësë dhe kamatës në datën e maturimit nga nënshkruesi I premtimit të shkruar, I quajtur debitor.
- Të arkëtueshmet tjera nuk rezultojnë nga transaksionet normale të biznesit, siç janë p.sh. Shitjet e mallrave dhe shërbimeve.

Kontabiliteti i borxheve të këqija

- Evidenca kontabël e shpenzimeve të borxheve të këqija bëhet nëpërmjet:
  - Metoda e uljeve
  - Metoda e shlyrjes direkte

7

Vlerësimi I llogarive të dyshimta

- Shembull:Le të supozojmë se firma "Elkos" gjatë vitit 2008 ka pasur shitje me afat pagese në vlerë prej 800.000 € nga të cilat në fund të vitit është vlerësuar se 100.000 € janë të pambledhshme. Depertamenti I shitjes ka vlerësuar se 7.000 € nga shitjet e këtij viti janë llogari të dyshimta dhe se ky vlerësim është bazuar në përvojen e shitjeve nga viti 2006 dhe 2007. Më datën 31.12.2008 në veprimet rregulluese llogaritë e dyshimta të vlerësuara nga "Elkos" I regjistron si vijon:

Ditari

Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Dhje	31	Shpenzimet e borxheve të këqija		7.000	
		Ulje për llogari të dyshimta			7.000
		Regj. i llogarive të dyshimta			

Shlyrjet e llogarive të dyshimta

- Shembull: Le të supozojmë se më 20 shkurt 2009 menaxheri i firmës "Elkos" ka vlerësuar se blerësi N nuk ka mundësi ta paguajë borxhin sepse ai ka falimentuar, prandaj autorizon kontabilitetin të shlyejë borxhin e tij në vlerë prej 2500 €.

Ditari

Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Shku	20	Ulje për llogari të dyshimta		2.500	
		Llogaritë e arkëtueshme			2.500
		Për shlyerjen e blerësit N			

Arkëtimet (rivendosja) e llogarive të dyshimta të shlyera më parë

- Shembull: Le të supozojmë se më 5.02.2009 "Elkos" ka arkëtuar në kesh 3000 €, në emër të borxheve të këqija të shlyera në vitin 2008.

Ditari

Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Shku	5	Llogaritë e arkëtueshme		3.000	
		Ulje për llogaritë e dyshimta			3.000
		Rivendosja e llogarive të dyshimta			

10

- Regjistrimi i dytë:

Ditari

Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Shku	5	Paraja e gatshme		3.000	
		Llogaritë e arkëtueshme			3.000
		Për arkëtimin e borxheve të këqija			

11

Metoda e shlyrjes direkte

- Sipas kësaj metode borxhet e këqija nuk vlerësohen, por ato drejtpërdrejt shlyhen.
- ***Shembull:*** Me 25 janar 2008 menaxheri financiar i "Elkos"-it ka autorizuar shërbimin e kontabilitetit për ta shlyer në tërësi blerësin S në vlerë prej 4000 euro sepse i njëjti është në likuidim.

Ditari

Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Jan	25	Shpenzimet e borxheve të këqija		4.000	
		Llogaritë e arkëtueshme			4.000
		Shlyerja e blerësit "S"			

12

Shitja e llogarive të arkëtueshme

- Shembull: më 10.11.2008 "Ylli Bec" ika shitur Bankës X një blerës në shumë prej 90000 euro, duke i ofruar një provizion 3 % për shërbime.

Ditari

Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Nënt	10	Paraja e gatshme		87.300	
		Shpenz e provizionit (3%)		2.700	
		Llogaritë e arkëtueshme			90.000
		Regj i shitjes së blerësve			

13

Dëftesat e arkëtueshme

- **Zakonisht përdoren:**
  - Në dhënien e kreditit;
  - Në shitjen e mallrave dhe shërbimeve, dhe
  - Për blerjen e blerësve tregtarë të debitorit (nënshkruesit të dëftesës së arkëtueshme)

14

Dëftesat e arkëtueshme në dhënien e kreditit

- ***Shembull:*** "Banka Ekonomike" më 1 nëntor 2007 i lejon një hua "Ylli Bec" në këmbim të një dëftese të pranueshme të nënshkruar nga kjo kompani me kushtet: vlera nominale (kryegjëja) 70000, norma e kamatës 9%, data e emetimit 1 nëntor, periudha e maturimit 3 muaj.

Ditari

Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Nënt	1	Dëftesat e arkëtueshme		70.000	
		Paraja e gatshme			70.000
		Për dhënjen e huasë			

15

- Më 31 dhjetor 2007, Banka Ekonomike bën veprimet rregulluese:

Ditari

Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Nënt	31	Kamata e arkëtueshme		1.050	
		Të hyra nga kamata			1.050
		Regjistrim i të hyrave nga veprimet rregulluese			

16

- Më shkurt 2008 Banka Ekonomike arkëton në tërësi shumë e kryegjesë dhe kamatën ndaj dëftesës së arkëtueshme.

Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Shku	1	Paraja e gatshme		71.575	
		Dëftesë e arkëtueshme			70.000
		Të hyrat nga kamata			525
		Kamata e arkëtueshme			1.050
		Arkëtim i dëftesës së arkëtueshme			

17

Dëftesat e arkëtueshme në shitjen e mallrave

- Le të supozojmë se më 1 shtator 2008 firma PPC I ka shitur "Ylli Bec" 40 kompjuter në vlerë 20000 eur. Meqenëse "Ylli Bec" aktualisht nuk posedon para të gatshme mjaftueshëm dhe kështu I sjell PPC-së një dëftesë të premtueshme me maturim prej 3 muajve dhe me normë të kamatës 10% të cilen PPC e pranon.

Ditari

Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Shtat	1	Dëftesat e arkëtueshme		20.000	
		Të hyrat nga shitjet			20.000
		Shitja e PC me dëftesë të arkëtueshme			

18

- Më 1 dhjetor në datën e maturimit PPC arkëton shumën e kryegjesë (principalin) dhe kamatën prej "Ylli Bec", dhe ben regjistrimin:

Ditari					
Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Dhje	1	Paraja		20.500	
		Dëftesat e arkëtueshme			20.000
		Të hyrat nga kamata			500
		Arkëtimi I dëftesës së arkëtueshme			

19

Dëftesat e arkëtueshme në këmbimin e blerësve

- Le të supozojmë se më 20.06.2008 "Ylli Bec" nuk ka mund të përmbushë në kohë faturën e blerjes ndaj "Elkos"-it në vlerë 50000 eur.
- Prandaj "Ylli Bec" bën një marrëveshje me Bankën Ekonomike që ajo të bëj pagesën ndaj "Elkos"it në këmbim të një dëftese të premtueshme nën kushtet vlera nominale 50000, periudha e amturimit 3 muaj, me normë të kamatës 10%.

Ditari					
Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Qer	20	Dëftesat e arkëtueshme		50.000	
		Llogaritë e arkëtueshme			50.000
		Për transferimin e blerësit "Elkos"			

- Më 20 shtator "Ylli Bec" ka paguar në tërsi në para të gatshme vlerën nominale dhe kamatën rrjedhëse të dëftesës së pagueshme.
- Banka Ekonomike bën regjistrimin kontabël:

Ditari					
Data		Përshkrimi		Debi	Kredi
Shta	20	Paraja		51.250	
		Dëftesë e arkëtueshme			50.000
		Të hyrat nga provizioni			1.250
		Arkëtimi i dëftesës së arkëtueshme			

Llojet e pasurisë

- Dy llojet e pasurisë afatgjatë:
  - **Pasuria afatgjatë materiale** - patundshmeritë, impiantet dhe pajisjet;
  - **Pasuria afatgjatë jomateriale** (e paprekshme) - patentat, licencat, shenja tregtare, etj.

22

- Ndërmarrja tregtare "Ylli Bec" më 5.03.2007 ka blerë tokë në vlerë prej 300.000 euro me afat pagese 2 muaj. "Ylli Bec" ka paguar 4.000 euro në para të gatshme në emer të tatimit në pronë, 800 euro në emer të taksave të shitjes së pronës, 500 euro për matjen e tokës dhe 300 euro për vendosjen e shenjave të tokës.

23

Shembull 1:

- Kompania A është një prodhues kompjuterësh. Ka blerë një pajisje më 31 dhjetor e cila do të përdoret për prodhim. Fatura nga pala shitëse i përmban artikujt në vijim:
-
- Çmimin shitës 150,000 €
- Transportimi 20,000
- Çmimi i vendosjes 8,000
- Çmimi i trajnimit të punëtorëve për prodhim 5,000
- Kontrata 1 vjeçare për shërbime të mirëmbajtjes 12,000
- TOTALI 195,000

- Përveç kësaj, kompania A i ka paguar edhe elektricistit 200 € për të instaluar një priz të re elektrike për makinën. Megjithatë, kompania A ka vendosur që ta ndërrojë vendin e makinës pasi që elektricisti ka filluar punën, kështu që ka pasur një kosto shtesë prej 50 € për ta riparuar një vrimë të panevojshme që është shpuar në mur.

Shembull 1:

DITARI

Data		Përshkrimi	Debi	Kredi
dd	mm	Makineritë	178,200	
		Paraja		178,200
		Pagesa për blerjen e makinerisë		

DITARI

Data		Përshkrimi	Debi	Kredi
dd	mm	Shpenzimet e trajnimit të stafit	5,000	
		Paraja		5,000
		Pagesa e shpenzimeve për trajnim të stafit		

Shembull 1:

DITARI

Data		Përshkrimi	Debi	Kredi
dd	mm	Shpenzimet e parapaguara	12,000	
		Paraja		12,000
		Pagesa e avansit për mirëmbajtje të makinerisë		

DITARI

Data		Përshkrimi	Debi	Kredi
dd	mm	Shpenzimet e riparimit	50	
		Paraja		50
		Pagesa e shpenzimeve të riparimit të murit		

Zhvleresimi, Amortizimi dhe Shterrja (Harxhimi)

Definimi i shprehjeve të zhvlerësimit

Zhvlerësimi
Proces i shpërndarjes së shpenzimeve që përcakton koston origjinale të ndërtesës dhe pajisjeve gjatë periudhës së caktuar.

Vlera kontabël
Për asetet operative afat gjata, vlera kontabël është e barabartë me koston origjinale të pasurisë (aseteve) minus çdo zhvlerësim i akumuluar.

Vlera e mbetur
Shuma që pritet të pranohet kur pasuria (aseti) shitet në fund të jetës së tij të përdorimit.

Jetëgjatësia
Paraqet numrin e viteve sa mund të qëndroj mjeti në përdorim

Numri i njësive
Paraqet sasinë e njësive që mund të prodhoj ose të kaloj një pajisje përgjatë tërë jetëgjatësisë së saj.

Faktori i shpenzimeve të zhvlerësimit



Pozicionimi i Zhvlerësimit në pasqyrat financiare



Shembull

Kosto fillestare.....	€55,000
Jetëzgjatja në vite…….....	5 vite
Vlera e mbetur.....	€5,000

Metoda lineare (vijëdrejtë)

$$\frac{\text{Kosto} - \text{Vlera e mbetur}}{\text{Jetëzgjatja}}$$

= Zhvlerësimi vjetor

Metoda lineare (vijëdrejtë)

$$\frac{55{,}000€ - 5{,}000€}{5 \text{ vite}}$$

= 10,000 € zhvlerësim vjetor

Metoda lineare (vijëdrejtë)

$$\frac{€55{,}000 - €5{,}000}{5 \text{ vite}} = €10{,}000$$

$$\frac{€10{,}000 \times 100}{€55{,}000} = 18{,}3\%$$

Metoda lineare (vijëdrejtë)

Metoda vijëdrejtë shfrytëzohet shumë nga firmat sepse është më e thjeshtë dhe ofron një transferim të arsyeshëm të kostos në shpenzime të periudhës nëse pasuria (aseti) shfrytëzohet njëjtë në të gjitha periudhat.

Metoda lineare (vijëdrejtë)

Vitet	Kosto	Zhvl.i akum. në fillim të vitit	Vlera kontabël në fillim të vitit	Shpenz. e zhvler. në fund të vitit	Vlera kontabël në fund të vitit
1	€24,000		€ 24,000	€4,400	€19,600
2	24,000	€ 4,400	19,600	4,400	15,200
3	24,000	8,800	15,200	4,400	10,800
4	24,000	13,200	10,800	4,400	6,400
5	24,000	17,600	6,400	4,400	2,000

$$\frac{\text{Kosto (€24,000)} - \text{Vlera e mbetur (€2,000)}}{\text{Jetëzgjatja (5 vite)}}$$

Shpenzimet vjetore të zhvlerësimit (€4,400)

Metoda për njësi të produktit

Hapi 1:

$$\text{Zhvlerësimi Për njësi} = \frac{\text{Kosto - Vlera e mbetur}}{\text{Njësitë totale të produktit}}$$

Hapi 2:

$$\text{Shpenzimet e zhvlerësimit} = \text{Zhvlerësimi Për njësi} \times \text{Numri i njësive të prodhuara brenda periudhës}$$

Metoda për njësi të produktit

Më 31 dhjetor 2006, është blerë pajisja me para për €50,000. Pajisja pritet të prodhoj 100,000 njësi gjatë jeëtzgjatjes së saj dhe ka vlerë të mbetur prej €5,000.

Nëse janë prodhuar 22,000 njësi gjatë vitit 2007, çfarë është shuma e shpenzimeve të zhvlerësimit?

Metoda për njësi të produktit

Hapi 1:

$$\text{Zhvlerësimi për njësi} = \frac{€50{,}000 - €5{,}000}{100{,}000 \text{ njësi}} = €0{,}45 \text{ për njësi}$$

Hapi 2:

$$\text{Shpenzimet e zhvlerësimit} = €\ 0{,}45 \text{ për njësi} \times 22.000 \text{ njësi} = €9.900$$

Metoda për njësi të produktit

Viti	Njësi	Shpenzimet e zhvlerësimit	Balanca e zhvlerësimit të akumuluar	Vlera kontabël (Balanca e pa zhvlerësuar)
2001				$ 50,000
2002	22,000	$ 9,900	$ 9,900	40,100
2003	28,000	12,600	22,500	27,500
2004	-	-	22,500	27,500
2005	32,000	14,400	36,900	13,100
2006	18,000	8,100	45,000	5,000
	100,000	$ 45,000		

Vlera e mbetur

Nuk ka shpenzime të zhvlersëimit nëse pajisja nuk punon.

Zhvlerësimi parcial - vjetor

Kur aseti sigurohet brenda vitit, zhvlerësimi kalkulohet për pjesën e vitit në të cilën aseti shfrytëzohet.

Zhvlerësimi parcial - vjetor

Cilët janë dy hapat e llogaritjes së shpenzimeve të zhvlerësimit për kohë më të shkurtër se një vit?

Së pari, kalkulo shpenzimet e zhvlerësimit për tërë vitin.

Së dyti, shpërndaje atë njëjtë për numrin e muajve gjatë vitit që përdoret asetit .

Zhvlerësimi parcial - vjetor

Kalkulo zhvlerësimin sipas metodës vijëdrejtë më 31 dhjetor 2007, për pajisjen e blerë më 30 qershor 2007. Kosto e pajisjes është €75,000, me një jetë-zgjatje prej 10 vjet dhe me vlerë të mbeturt prej €5,000.

Zhvlerësimi = (€75,000 - €5,000) ÷ 10
= €7,000 për tërë vitin
Zhvlerësimi = €7,000 × $^{6}/_{12}$ = €3,500

Burimet natyrore

Kosto totale, duke përfshirë eksplorimin dhe zhvillimin, është ngarkuar të boshatiset (zbrazet) gjatë tërë periudhës përfituese.

E nxjerrur nga mjediset natyrale dhe e raportuar si kosto minus zbrazja e akumuluar.

Shembull: nafta, thëngjilli, ari

Boshatisja (zbrazja) e burimeve natyrore

Boshatisja kalkulohet duke shfrytëzuar metodën për njësi të produktit.

Shkalla e boshatisjes për njësi kalkulohet si vijon:

$$\frac{\text{Kosto - Vlera e mbetur}}{\text{Njësitë totale të kapacitetit}}$$

Boshatisja (zbrazja) e burimeve natyrore

Kosto totale e boshatisjes për periudhën është:

Shkalla e boshatisjes për njësi × Numri i njësive të nxjerrura brenda periudhës

Kosto totale e boshatisjes → Inventari për shitje → KMSH; Inventari i pa shitur

Shembull: Boshatisja (zbrazja)

Mihja sipërfaqësore ...nxjerrë përafërsisht 200,000 ton thëngjill. Shpenzimet e zbrazjes (boshatisjes) për secilin ton të thëngjillit janë €6. Përcakto regjistrimet në ditar nëse janë minuar 12,000 ton.

Shpenzimet e zbrazjes 72,000
Zbazja (boshatisja) e akumuluar,Min. e thëngj. 72,000
Regjistrimi i boshatisjes për tërë vitin: *€12,000 me €6 për ton.*

Hedhja e aseteve fikse

Nëse Paraja > VL, regjistro fitim (kredi).
Nëse Paraja < VL, regjistro humbjen (debi).
Nëse Paraja = VL, s'ka fitim apo humbje.

Duke regjistruar paranë e pranuar (debi) apo të paguar (kredi).

Duke regjistruar fitimin (kredi) apo humbjen (debi).

Bartja e zhvlerësimit të akumuluar në debi

Bartja e kostos së aseteve në kredi

Hedhja e aseteve fikse

Një pjesë e pajisjes e siguruar me kosto prej 25.000 € është zhvlerësuar në tërësi. Më 14 shkurt pajisja është hedhur.

Hedhja e aseteve fikse

	14	shk.	Zhvlerësimi i akumuluar-pajisjet			25	000	00			
			Pajisjet						25	000	00
			Shlyerja e tërësishme e pajisjes së								
			zhvlerësuar.								

Hedhja e aseteve fikse

Pajisja që kushton 13,000 € është zhvlerësuar në baza vjetore prej 10 %. Pas regjistrimeve rregulluese, ***Zhvlerësimi i akumuluar-pajisja*** ka balancë kreditore prej 13.000 €. Kompania në emër të çmontimit ka paguar 500 €. Çfarë janë regjistrimet?

	24	Mar	Zhvlerësimi i akumuluar-pajisja			13	000	00			
			Humbja në hedhjen e asetit fiks				500	00			
			Pajisja						13	000	00
			Paraja							500	00
			Shlyerja e asetit të hedhur								

Hedhja e aseteve fikse

Pajisja që kushton 13,000 € është zhvlerësuar në baza vjetore prej 10 %. Kompania ka vendosur që këtë pajisje ta hudhë pas vitit të tetë, me ç'rast në emër të çmontimit ka paguar 500 €. Pas regjistrimeve rregulluese, ***Zhvlerësimi i akumuluar-pajisja*** ka balancë kreditore prej 10.400 €.

	24	Mar	Zhvlerësimi i akumuluar-pajisja			10	400	00			
			Humbja në hedhjen e asetit fiks			3	100	00			
			Pajisja						13	000	00
			Paraja							500	00
			Shlyerja e asetit të hedhur								

Shitja e aseteve fikse

Kur aseti fiks shitet, vlera kontabël mund të mbulohet, të krijoj humbje apo të realizoj fitim.

1. Nëse çmimi shitës është i barabartë me vlerën kontabël, atëherë nuk do të kemi as fitim dhe as humbje.
2. Nëse çmimi shitës është më i vogël se vlera kontabël, atëherë do të kemi humbje të barabartë me diferencën.
3. Nëse çmimi shitës është më i madh se vlera kontabël, atëherë do të kemi fitim të barabartë me diferencën.

Fitimi apo humbja do të raportohen në raportin e të ardhurave si të ardhura të tjera apo Humbje të tjera.

Shitja e aseteve fikse



Standard Benz ka blerë një sistem transportues për €15,000. Kjo pajisje ka një afat shfrytëzimi prej 5 viteve, pa vlerë të mbetur dhe me zhvlerësim sipas metodës lineare. Nëse Standard hedhë në mbeturinë sistemin pas 4 viteve të shfrytëzimit, ajo do të ketë humbje për €3,300. Çfarë është regjistrimi i përshtatshëm në ditar?

Zhvlerësimi i akumuluar, Sistemi transp. . . . 12,000
Humbja nga heqja e transport. 3,300
Sistemi transp.. 15,000
Paraja 300

Shitja e aseteve fikse



Standard Benz ka blerë një sistem transportues për €15,000. Kjo pajisje ka një afat shfrytëzimi prej 5 viteve, pa vlerë të mbetur dhe me zhvlerësim sipas metodës lineare. Nëse transportuesi shitet për € 600 pas vitit të 5 të shfrytëzimit, çfarë janë regjistrimet në ditar?

Paraja.	600	
Zhvlerësimi i akumuluar, Transportuesi . . .		15,000
Transportuesi.		15,000
Fitimi nga shitja e transportuesit.		600

Shitja e pasurisë fikse



Standard Benz ka blerë një sistem transportimi për €15,000. Kjo pajisje ka jetë zgjatje prej 5-viteve, pa vlerë të mbetur dhe zhvlerësim sipas metodës lineare. Nëse sistemi transportues shitet për €600 pas vetëm 4 viteve të shfrytëzimit, Standard do të krijoj humbje për €2,400. Kryeni regjistrimet e nevojshme.

Paraja.	600	
Zhvlerësimi i akumuluar, Transportuesi . .		12,000
Humbja nga shitja e transp..	2,400	
Transportuesi		15,000

Shitja për €15,000 e transp. me humbje për €2,400.

Asetet e paprekshme

Çfarë janë Asetet e pa prekshme?

Të drejta dhe privilegje:

- ✓ afat gjatë
- ✓ që nuk janë për rishitje
- ✓ nuk kanë substancë fizike
- ✓ zakonisht u ofrohen pronarëve me përparësi konkurruese ndaj firmave tjera

Amortizimi

- ✓ Shpërndarje periodike e shpenzimeve të aseteve të pa prekshme.
- ✓ Konceptualisht, njëjtë si zhvlerësimi.
- ✓ Asetet e pa prekshme përgjithësisht shfrytëzojnë metodën lineare të amortizimit.

Patenta

Shembull: Supozojmë se kompania ka blerë, duke paguar me para në dorë një patentë prodhimi nga një shpikës. Kostoja e blerjes së patentës që përbëhet nga çmimi i blerjes dhe shpenzimet tjera të mundshme, supozohet të jetë 28.000 €.

Patenta 28.000
Paraja..... 28.000

Amortizimi i Patentës

Kalkulo amortizimin për secilin prej 8 viteve.

Patenta prej €200,000 me jetë zgjatje prej 8 viteve:



Përfitimi

- Viti 1 – €25,000
- Viti 2 – €25,000
- Viti 3 – €25,000
- Viti 4 – €25,000
- Viti 5 – €25,000
- Viti 6 – €25,000
- Viti 7 – €25,000
- Viti 8 – €25,000

Licenca

- **Shembull:** Ndërmarrja për prodhimin e këpucëve e ka paguar shumën prej 100.000 € një firme të njohur, në emër të licencës për prodhimin e llojit të njohur të këpucëve sportive me kushtet që janë rregulluar me kontratë.

Licenca 100.000
Paraja 100.000

E drejta e autorit

- **E drejta e autorit** - përfaqësohet nga një ligj që synon të mbrojë punën e një artisti, shkencëtari, shkrimtari etj. nga kopjimi apo riprodhimi i veprës së tyre nga persona të tjerë. Idetë kryesore të çdo artisti të materializuar në pikturë, disk, novele, roman, kasetë etj. lindin të drejtën e autorit në mënyrë automatike pa pasur nevojë që të bëhet ndonjë regjistrim paraprak ligjor të tyre siç veprohet me rastin e markës apo patentës. Për njësinë e biznesit, e drejta e autorit do të paraqesë vlerën e blerjes së një të drejte nga autori i saj, psh të drejtën e botimit të një romani, të prodhimit të një disku muzikor etj.

Goodwill (Emri i mirë)

- Një aset i pa prekshëm që ekziston kur biznesi vlerëson asetet e tij më tepër se vlera e tregut, zakonisht me rastin e:
  - Lokacionit strategjik
  - Reputacionit
  - Raporteve të mira me konsumatorin
  - Faktorëve të ngjashëm
- Ose kur çmimi i blerjes tejkalon vlerën fer të tregut të neto aseteve të blera.

Goodwill

Lajmërohet kur një kompani blenë një kompani tjetër

Vetëm goodwill I blerë është aset i paprekshëm

Shuma me të cilën çmimi shitës tejkalon vlerën reale të tregut në asetit të siguruar

Shembull: Goodwill



Standard Benz ka blerë Ardi Corp. për €1,200,000. Në momentin e blerjes Standard regjistron sipas vlerës së tregut asetet dhe detyrimet e saj:

Inventari	€750,000
Asetet operative afat gjata	220,000
Asetet tjera	25,000
Detyrimet	(18,000)
Gjithsej neto asetet	€977,000

Shembull: Goodwill

Standard Benz ka blerë Ardi Corporation për €1,200,000. Kryej regjistrimet në ditar në librat Standard Benz.

Inventari.	750,000	
Asetet operative afat gjata	220,000	
Asetet tjera.	25,000	
Goodwill	**223,000**	
Detyrimet.		18,000
Paraja		1,200,000

Blerja e Ardi Corp. për €1,200,000.